

KOMUNA SUHAREKË

DREJTORIA PËR EKONOMI, BUXHET DHE FINANCA

SEKTORI I TATIMIT NE PRONË

Sektori I tatimit në pronë në komunën e Suharekës në bazë ligjit dhe rregullorëve në fuqi, ka ngarkuar të gjithë qytetarët me tatim për tokat (oborre), malet dhe objektet në komunën e Suharekës për vitin 2022.

Të gjitha faturat për tatimin në pronë për tokat (oborre), malet (pyje) dhe objektet në komunën e Suharekës për qytetarët janë shpërndarë nga Posta e Kosovës me kontraktim nga komuna e Suharekës, në faturë është ngarkesa për 2022 dhe borxhet e mbetura të vitetve paraprake për ata që nuk kanë kryer obligimet.

Andaj ne si Komunë, Drejtoria e ekonomisë financave dhe buxhetit konkretisht sektori I tatimit në pronë, jemi të thirrur në bazë të ligjeve dhe rregullave në fuqi të ju informojmë lidhur me tatimet, obligimet, ngarkesat por edhe ankesat e kërkesat si dhe procedurat në drejtorinë tonë, në Komunën e Suharekës.

Kërkojmë nga të gjithë qytetarët të paguani obligimet tatimore, sepse nëse ni qytetar kalon vlerën mbi 300.00 euro e më shumë obligim të tatimit, me ligj jemi të detyruar të dërgojmë lëndën në procedurë përmbarimore, e kjo është dëshira jonë dhe e juaja e fundit për mbledhjen e tatimit.

Shpërndarja e faturave të tatimit në Pronë është në proces.

Të drejtat e qytetarëve - Kërkesa dhe ankesat

1. Ankesë ndaj çertifikatës së vlerës së vlerësuar

Me anë të kësaj ankese qytetarë të nderuar ju që jeni të pakënaqur në vlersim, mundë të kërkonit rivlersim nëse mendoni se një tokë (oborr), mal (pyll) ose objekt është vlerësuar në menyrë të pasaktë ose jo korrekte, u është ndryshuar kategoria, zona, sipërfaqja, standardi - gjendja faktike apo gabime tjera.

Ankesa mundë të bëhet në zyrat e tatimit në pronë Suharekë ose në Ministrinë e Financave dep. I pronës, shqyrtimin e kësaj ankese e bën Prishtina.

2. Ankesë ndaj faturës së Tatimit në Pronë

Me anë të kësaj ankese qytetarë të nderuar ju që jeni të pakënaqur ndaj faturës së tatimit në pronë për shkak të gabimeve eventuale shembull tatimpaguesi është I pasaktë, vlera tatimore, norma tatimore, gjobat, gabime në regjistra apo gabime tjera jo korrekte që nuk mundë të jenë në kundërshtim me ligjin mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme 06/L-005.

Ankesa bëhet në zyret e tatimit në pronë Suharekë.

3. Kërkesë për Korigjim

Me anë të kësaj kërkesë qytetarë të nderuar ju mundë të kërkonit nga zyrat e Tatimit në Pronë në Suharekë të shqyrtoj dhe korigjojë gabimet eventuale, gabime në shkrim, në lidhje me tatimpaguesin, gabimet me sipërfaqe, gabimet në klasifikim, gabimet me pikën e vendndodhjes dhe gabime tjera.

Shqyrtimin e kërkesës e bën zyrtari I lartë I Tatimit në Pronë Suharekë.

Afati për ankesa dhe kërkesa ka filluar nga 01.03.2022 dhe përfundon me 30.04.2022

Për informata shtesë ju lutemi lajmrohuni në zyret e Drejtorisë së Financave Suharekë.

Paguani taksat dhe tatimet, instrumente financiare me anë të të cilave ndihmoni në përmisimin e qdo sektori në mirëqenien e qytetarëve, krijo një shtet dhe komunë të fuqishme.

Drejtoria e Ekonomisë Financave dhe Buxhetit –Suharekë